




ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHËTETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtër për politika publike nr. 17/2021

**Përfaqësimi i interesave të
qytetarëve nga deputetët -
e vërtetë apo mit**

Autor: Zdravko Stavrov

qershor 2021



Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP implementohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci “Societas Civilis” - Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Përmbajtja e botimit në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e SDC-së.

Përmbajtjes

1.	Hyrje	1
2.	Analiza krahasuese e sondazheve në terren të kryera në periudhën 2018-2021	2
3.	Analizë sipas rajoneve për qëndrimet e qytetarëve nga viti 2021	5
4.	Përfundim	7
5.	Rekomandime	8

1. Hyrje

Në demokraci përfaqësuese, Kuvendi ka një nga rolet më të rëndësishme. Përveç se është dhomë ligjvënëse, është edhe institucion përfaqësues i qytetarëve.

Por sondazhet e opinionit publik sugjerojnë të kundërtën. Sipas shifrave nga sondazhet në terren të kryera në periudhën 2018-2021 nga Instituti për demokraci (IDSCS), përcaktohet që qytetarët besojnë se interesat e tyre nuk përfaqësohen gjithmonë në dhomën përfaqësuese. Kjo analizë krahasuese e të dhënave të fituara nga sondazhi vjetor i IDSCS mbi punën e Kuvendit është në mënyrë që të përcaktohet nëse ka ndonjë ndryshim të caktuar në qëndrimin e qytetarëve ndër vite.

Analiza krahasuese i referohet posaçërisht një pjese specifike e cila është shumë e rëndësishme për funksionimin dhe besueshmërinë e deputetëve të Kuvendit. Në mënyrë të veçantë, kjo analizë i referohet asaj sesa shpesh deputetët përfaqësojnë interesat në vijim: personale, të partisë së tyre politike, biznes interesat dhe interesat e qytetarëve.

Sipas Giger dhe Kluver¹ deputetët veprojnë si agjentë të dy drejtorëve të ndryshëm, domethënë votuesve të tyre dhe partisë së tyre politike, të cilën ata duhet ta kënaqin për të siguruar rizgjedhjen e tyre.

Megjithatë votuesit dhe parti politike sipas tyre¹ nuk janë aktorët e vetëm të rëndësishëm që ndikojnë

mbi ligjvënësit. Deputetët janë të ekspozuar në mënyrë plotësuese ndaj një game të gjerë të grupeve të interesit (biznes grupe, organizata) që duan të ndikojnë në votat e tyre legjislative. Palët e interesuara kërkojnë të ndikojnë mbi krijimin e politikave publike duke zbatuar strategji të ndryshme të lobimit. Qëllimi i tyre kryesor është formimi i vendimeve për kritikën në favor të tyre duke kërkuar të ndikojnë mbi deputetët të caktuar dhe grupet e partive. Kështu që ata duhet të japin votat legjislative në përputhje me preferencat politike të grupeve të interesit.

Giger dhe Kluver² në hulumtimin e tyre, argumentojnë se grupet e interesit ofrojnë tre përfitime për ligjvënësit të cilët nga ana tjetër përshtaten me kërkesat e tyre kur japin votën e tyre në Kuvend: informacione, kontribute në fushatë dhe interesa personale.

Kjo analizë e shkurtër së pari shqyrton perceptimin e përgjithshëm të qytetarëve për atë se interesat e kujt përfaqësojnë deputetët në Kuvend, pastaj analizon në mënyrë më të detajuar qëndrimet e qytetarëve nga rajone të ndryshme të vendit dhe në fund jep rekomandime se si të përmirësohet situata aktuale.

¹ Giger. N., & Kluver. N. (2016). "Votimi kundër zgjedhësve tuaj? Si lobimi ndikon mbi përfaqësimin", Revista Amerikane e Shkencave Politike, 6(1), 190-205.

² Ibid


2. Analiza krahasuese e sondazheve në terren të kryera në periudhën 2018-2021

Palët e interesuara mund të sigurojnë përfitime personale që ligjvënësit marrin gjatë ose pas përfundimit të mandatit të tyre. Në literaturë, bëhet një dallim midis përfitimeve të grupeve të lobit dhe ndikimit të grupeve të interesit në perspektivat e ardhshme të karrierës së deputetëve. Opsioni i parë përfshin sigurimin e punësimit (anësor) të deputetëve, dhënien e dhuratave ose i ftojne në biznes udhëtime të shtrenjta. Nga ana tjetër, opsioni i dytë i referohet mundësive të karrierës pas dorëheqjes ose përfundimit të mandatit të deputetëve (për shembull, emërim në bordet e kompanive). Këto lidhje shkëmbimi paguhen për të dy palët, kompanitë me lidhje personale dhe financiare dhe politikanët gëzojnë

vlerësime më të larta në bursë, ndërsa deputetët marrin paga dukshëm më të larta.³

Perceptimi i qytetarëve është që deputetët shpesh përfaqësojnë interesa personale, megjithëse ky perceptim ndryshon dhe shënon rënie. Përkatësisht, në vitin 2019, 78% e të anketuarve⁴ kanë konsideruar se politikanët gjithmonë përfaqësojnë interesat personale, ndërsa në vitin 2021⁵ përqindja e qytetarëve që mendojnë kështu zvogëlohet në 70%. Sidoqoftë, mbi dy të tretat e qytetarëve kanë perceptim negativ për punën e deputetëve, të cilët pritet të përfaqësojnë interesat e qytetarëve, dhe jo ato personale.

Tabela 1. Rezultatet sipas viteve në lidhje me pyetjen "Sa shpesh përfaqësojnë deputetët interesat e tyre personal?"



³ Faccio, Mara. (2006). "Firmat politikisht të lidhura". Revista Ekonomike Amerikane, 96(1), 369-386.


⁴ IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2019).

⁵ IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2021).

Kur bëhet fjalë për interesat e qytetarëve, sipas të dhënave nga sondazhet në terren nga viti 2018 deri në vitin 2021, qytetarët besojnë se deputetët nuk arrijnë të përfaqësojnë interesat e tyre në Kuvend. Në vitin 2018⁶ vetëm 10% e të anketuarve menduan se deputetët gjithmonë përfaqësojnë interesat e tyre (qytetarëve). Kjo përqindje e vogël shënon rënie në vitin 2019⁴ kur është 7%, dhe në vitin 2020⁷ vetëm 6% e qytetarëve kanë konsideruar se deputetët përfaqësojnë interesat

e tyre në dhomën përfaqësuese. Ndryshe nga viti 2020, në vitin 2021⁵ shënohet rritje e lehtë prej 3 pikë të përqindjes, me atë që 10% e qytetarëve të anketuar kanë konsideruar se deputetët gjithmonë përfaqësojnë interesat e tyre. Besimi i ulët i qytetarëve se deputetët e tyre përfaqësojnë interesat e tyre në dhomën përfaqësuese, bie ndesh me një nga rolet më të rëndësishme parlamentare, si "të zgjedhur të popullit".

Tabela 2. Rezultatet sipas viteve në lidhje me pyetjen "Sa shpesh përfaqësojnë deputetët interesat e qytetarëve?"




Palët e interesuara janë burim i rëndësishëm i financimit, pasi ato shpesh japin kontribute për fushatat e politikanëve. Kur bëhet fjalë për biznes interesat, përqindja e qytetarëve që mendojnë se deputetët përfaqësojnë këto interesa është më e ulët, krahasuar me perceptimin se ata më shpesh, nëse jo gjithmonë, përfaqësojnë interesa personale. Në vitin 2018,⁷ 65% e të anketuarve deklaruan se deputetët përfaqësojnë gjithmonë biznes interesat, ndërsa në vitin e ardhshëm 2019⁴ ky perceptim ulet,

me atë që 58% e të anketuarve që mendojnë kështu. Në vitin 2020⁶, pak më pak se gjysma e të anketuarve (47%) deklaruan se deputetët përfaqësojnë gjithmonë biznes interesat, ndërsa në vitin 2021⁵ ky perceptim rritet me 10% të jashtëzakonshëm dhe është 57%. Këto përqindje pasqyrojnë mendimin e qytetarëve, të cilët besojnë se megjithatë bëhet fjalë për animin kah kapitali nga ana e deputetëve.

⁶ IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2018).

⁷ IDSCS. "Rezultatet nga anketa në terren mbi perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit" (2020).


Tabela 3. Rezultatet sipas viteve në lidhje me pyetjen "Sa shpesh përfaqësojnë deputetët biznes interesat?"



Të gjithë deputetët në të dy përbërjet që janë përfaqësuar në periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2021 përfaqësojnë një parti të caktuar politike, por kjo nuk do të thotë që ata duhet të përfaqësojnë ekskluzivisht interesat e partisë nga vijnë, veçanërisht duke marrë parasysh që sipas nenit 62 të Kushtetutës së RMV-së, deputetët fillimisht përfaqësojnë qytetarët në Kuvendin e RMV-së dhe vendosin në Kuvend sipas bindjes së tyre. Megjithatë, të dhënat nga sondazhi në

terren tregojnë se qytetarët mendojnë pikërisht të kundërtën. Në vitin 20185 një rekord prej 82% e të anketuarve thanë se deputetët gjithmonë përfaqësojnë interesat e partisë. Ky mendim do të ndryshojë pak vitin e ardhshëm, pra në vitin 20194 kur është 72%, që të rritet minimalisht në vitin 20206 kur është 73%. Në vitin 2021,5 76% e të anketuarve kanë menduar se deputetët përfaqësojnë gjithmonë interesat e partisë.

Tabela 4. Rezultatet sipas viteve në lidhje me pyetjen "Sa shpesh përfaqësojnë deputetët interesat e partisë së tyre politike?"



3. Analizë sipas rajoneve për qëndrimet e qytetarëve nga viti 2021

Rezultatet nga të gjitha rajonet tregojnë zhgënjim të madh të qytetarëve në lidhje me përfaqësimin e interesave të tyre nga deputetët.

Në rajonin e Vardarit, megjithëse 14% janë deklaruar se çdo herë janë përfaqësuar interesat qytetare nga deputetët, është një nga rezultatet më të mira në këtë pjesë të hulumtimit. Pason rajoni Lindor me 13%, Jugperëndimor me një 4% të vogël. Një nga përqindjet më të mira, por ende

të vogla është në rajonin Juglindor me 15%. Në rajonin e Pellagonisë, zhgënjimi i qytetarëve në lidhje me përfaqësimin e interesave të tyre është i dukshëm dhe është vetëm 5%. Zhgënjimi më i madh është në rajonin e Pollogut, ku vetëm 3% e të anketuarve thanë se ata janë gjithmonë të përfaqësuar. Më i mirë midis të gjithë rajoneve është rezultati i rajonit Verilindor, 18%. Në rajonin e Shkupit ekziston një mendim i ngjashëm midis të anketuarve si në rajonet e tjera dhe është 12%.

Tabela 5. Rezultatet sipas rajoneve në lidhje me pyetjen "Sa shpesh përfaqësojnë deputetët interesat e qytetarëve?"

Rajoni	I Vardarit	Lindor	Jug-Perëndimor	Jug - Lindor	I Pellagonisë	I Pollogut	Veri - Lindor	I Shkupit
Gjithmonë	14%	13%	4%	15%	5%	3%	18%	12%
Ndonjëherë	77%	46%	30%	64%	45%	59%	51%	50%
Asnjëherë	10%	41%	65%	20%	48%	35%	30%	35%
Nuk e di	0%	0%	1%	1%	2%	3%	1%	3%

Të anketuarit nga rajoni i Vardarit deklaruan 75% se deputetët gjithmonë përfaqësojnë interesat e tyre personale. Në rajonin Lindor, 70% pajtohen, ndërsa rekordin në këtë pjesë e mban rajoni Perëndimor me një 96% të lartë. Me 71% janë deklaruar rajoni Juglindor, ndërsa në rajonin e Pelagonisë dhe Pollogut me 78% përkatësisht 58%.

Përqindjen më të ulët në këtë pjesë e kanë të anketuarit nga rajoni Verilindor, i cili është 33%, që është një përqindje e lartë, por shumë më e ulët se rajonet e tjera. Në rajonin e Shkupit ngjashëm si në shumicën e rajoneve dhe perceptimi se përfaqësohen interesat personale të deputetëve është 71%.

Tabela 6. Rezultatet sipas rajoneve në lidhje me pyetjen "Sa shpesh përfaqësojnë deputetët interesat e tyre personale?"

Rajoni	I Vardarit	Lindor	Jug-Perëndimor	Jug - Lindor	I Pellagonisë	I Pollogut	Veri - Lindor	I Shkupit
Gjithmonë	75%	70%	96%	71%	78%	58%	33%	71%
Ndonjëherë	23%	19%	3%	25%	19%	26%	35%	23%
Asnjëherë	1%	1%	0%	1%	2%	12%	25%	5%
Nuk e di	0%	10%	1%	4%	2%	4%	7%	1%

Në pjesën e interesave të partive të tyre politike nga hulumtimi, përqindjet janë më të ulëta në raport me interesat personale, por gjithsesi në rajone të caktuara ka një përqindje dukshëm më të lartë të prononcimit se gjithmonë përfaqësohen interesat e partisë së tyre.

Shembuj për këtë janë rajonet e Vardarit dhe Verilindor ku përqindja është e njëjtë, por edhe më e

larta krahasuar me rajonet e tjera dhe është 28%. Përafërsisht përqindje e afërt, por gjithsesi më e ulët paraqitet në rajonin Juglindor me 26%. Pason Shkupi me 18%, Rajoni Lindor me 13%, Pellagonija me 11%. Përqindja më e ulët është vërejtur në rajonin e Pollogut, ku vetëm 8% e të anketuarve deklaruan se interesat e partive përfaqësohen gjithmonë nga deputetë.

Tabela 7. Rezultatet sipas rajoneve në lidhje me pyetjen "Sa shpesh përfaqësojnë deputetët interesat e partisë së tyre politike?"

Rajoni	I Vardarit	Lindor	Jug-Perëndimor	Jug - Lindor	I Pellagonisë	I Pollogut	Veri - Lindor	I Shkupit
Gjithmonë	93%	86%	97%	75%	75%	75%	55%	69%
Ndonjëherë	7%	14%	2%	22%	23%	9%	39%	22%
Asnjëherë	0%	0%	0%	1%	1%	12%	4%	5%
Nuk e di	0%	0%	1%	1%	2%	4%	2%	4%

Biznes interesat janë një temë e cila diskutohet shpesh. Qëndrimi i të anketuarve dhe rezultatet e fituara tregojnë se një përqindje e lartë e qytetarëve besojnë se deputetët gjithmonë përfaqësojnë në Kuvend biznes interesat. Në rajonin e Vardarit, 70% e të anketuarve deklaruan se biznes interesat përfaqësohen gjithmonë nga deputetët. Në rajonin Lindor, janë deklaruar 67%,

ndërsa në rajonin Juglindor dhe Verilindor, 46% përkatësisht 33%. Përqindja është gjithashtu e lartë në rajonin e Shkupit ku është 59%. Sidoqoftë, më të larta dhe më shqetësuese janë të dhënat në rajonin Jugperëndimor dhe të Pellagonisë ku përqindja është 84% përkatësisht 77%. Përqindja më e ulët është në rajonin e Pollogut dhe është 24%.

Tabela 8. Rezultatet sipas rajoneve në lidhje me pyetjen "Sa shpesh përfaqësojnë deputetët biznes interesat?"

Rajoni	I Vardarit	Lindor	Jug-Perëndimor	Jug - Lindor	I Pellagonisë	I Pollogut	Veri - Lindor	I Shkupit
Gjithmonë	70%	67%	84%	46%	77%	24%	33%	59%
Ndonjëherë	20%	22%	10%	42%	19%	57%	31%	29%
Asnjëherë	2%	0%	0%	4%	1%	15%	23%	5%
Nuk e di	7%	11%	6%	8%	3%	4%	13%	7%

4. Përfundim

Kërkimet që zhvillohen në vazhdimësi disa vjet me radhë, konfirmojnë dyshimin e publikut se deputetët në përgjithësi nuk përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Përkundrazi, të dhënat tregojnë se qytetarët besojnë se deputetët në punën e tyre vënë në plan të parë interesat e tyre personale, biznes interesat dhe interesat e partisë së tyre politike. Me këtë shkelet një nga rolet kryesore të deputetëve dhe kjo është "të zgjedhurit e popullit", të cilët në plan

të parë duhet të kenë përfaqësimin e interesave të qytetarëve.

Rezultatet për vitin 2021 tregojnë se situata e tillë pasqyrohet pothuajse në të gjitha rajonet në vend, përkatësisht ka ndryshime shumë të vogla në mënyrën se si qytetarët nga njësi të ndryshme rajonale shikojnë në atë se interesat e kujt përfaqësojnë deputetët.

5. Rekomandime

Bazuar në të dhënat e paraqitura në këtë analizë të shkurtër, ne rekomandojmë që deputetët të ndërmarrin aktivitetet e mëposhtme për të përmirësuar perceptimin e qytetarëve për punën e tyre:

Justifikimi i epitetit të zgjedhur të popullit - Nevojitet komunikim më i madh i deputetëve me qytetarët, pavarësisht nga përkatësia politike, në mënyrë që të njihen më mirë me nevojat dhe problemet e qytetarëve.

Zyrat e hapura për takime - Ndërsa aktualisht ka më shumë se 40 zyra deputetësh në zonat elektorale lokale, deputetët duhet të bëjnë një përpjekje më të madhe për të hapur sa më shumë zyra deputetësh në qytetet e tyre të lindjes ose atje ku zgjidhen, më tej, ata gjithashtu duhet të sigurojnë përdorimin e duhur dhe të plotë të këtyre zyrave. Ato duhet të përdoren në maksimum për takimet e deputetit me qytetarët, në mënyrë që të marrin propozime direkt prej qytetarëve. Sipas hulumtimit në vitin 2021⁴ të Institutit për demokraci, 19% e të anketuarve deklaruan se mund të marrin pjesë në punën e Kuvendit përmes takimeve personale me deputetë, ndërsa 17% duke i bërë pyetje deputetit. Me këtë, nevoja e qytetarëve për komunikim më të madh me deputetët është e dukshme.

Takime me të gjithë aktorët shoqërorë - Përveç qytetarëve, deputetët duhet të kenë takime me sektorin e biznesit si bartës i ekonomisë në vend në mënyrë që të diskutojnë problemet reale dhe nevojat e këtij sektori të cilat përmes propozimeve dhe amendamenteve të deputetit/ es nëse miratohen, mund të zgjidhen. Këto takime duhet të jenë publike dhe transparente në mënyrë që të mos marrin perceptimin se bëhet fjalë për marrëveshje. Më mirë është këto takime të jenë midis deputetëve dhe subjekteve të organizuara, si odat dhe sindikatat, të cilat do të përfaqësojnë interesat e bizneseve dhe punonjësve.

Bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale - Për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve, deputeti dhe vetëqeverisja lokale duhet të kenë një koordinim të shpeshtë. Në këtë pjesë, deputeti mund të kontribuojë duke paraqitur direkt amendamente për mjetet nga buxheti të cilat, nëse pranohen, do të nënkuptojnë zhvillimin e vendit të origjinës dhe prej ku janë zgjedhur.



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHITETJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME

Dokument i shkurtër për politika publike nr. 17/2021

-

**Përfaqësimi i interesave të
qytetarëve nga deputetët -
e vërtetë apo mit**

Autor: Zdravko Stavrov

-

qershor 2021